



SBASHK Arsimimi sot

Mars, 2026


Gazeta elektronike

Plani i Punës së Komunikimit është pjesë e Planit Strategjik 2027-2030 të SBASHK-ut SBASHK mbajti punëtori dyditore për hartimin e planit të komunikimit 2027-2030



Gjatë muajit mars, SBASHK mbajti një punëtori dyditore për hartimin e Planit të Punës për Komunikimin 2027-2030 e cila është pjesë e Planit Strategjik të SBASHK-ut për të njëjtën periudhë. Tryezën e hapi kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i cili tha se SBASHK ka qenë në vazhdimësi i hapur me publikun përmes mediave ku edhe ka ndërtuar një bagazh në ... (faqe 3)

SBASHK apel mesimdhënësve të Arsimit Parauniversitar: Mos nënshkruani kontrata të reja të punës



Gjatë muajit mars SBASHK kishte dalë me një reagim pasi përsëri në disa komuna, e veçanërisht në komunën e Vushtrrisë... (faqe 4)

Falënderim për të gjitha angazhimet në misionin e shenjtë



Fillimet e marsit shënojnë Epopenë e UÇK-së. Mijëra qytetarë nga Kosova dhe viset tjera shqiptare ... (faqe 2)

Bisedë me kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj



E pyetëm se cila është pozita e mësuesit sot në shoqëri dhe ai ktheu fillimisht kujtesën në vitet e dekadat e shkuara... (faqe 3)

Pishtarë të dijes urime dita e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe



Të nderuar pishtarë të dijes, kolege e kolegë gëzuar dhe urime 7 Marsi, kjo ditë e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe ... (faqe 5)



Editorial

Falënderim për të gjitha angazhimet në misionin e shenjtë



Fillimet e marsit shënojnë Epopenë e UÇK-së. Mijëra qytetarë nga Kosova dhe viset tjera shqiptare shkojnë në Prekaz dhe lartësojnë kujtimin për Komandantin Legjendar, Adem Jashari dhe gjithë dëshmorët e kombit. Po në fillimet e marsit është edhe dita e mësuesit dhe shkollës shqipe. Kudo në shkolla organizohen programe artistike dhe shprehet respekti meritore për pishtarët e dijes, që dhanë kontribut me vlerë në edukimin e arsimimin e brezave.

Në çdo 7 Mars SBASHK organizon aktivitete e takime me pensionistët duke treguar se janë ata që me vite e dekada kanë kryer misionin e shenjtë për edukimin e brezave. Janë këto momente kur kthejmë kujtesën për datat dhe ngjarjet

e madha që kanë lënë gjurmë falë përpjekjeve e sakrificave sublime të njerëzve të pendës e armës për lirinë e atdheut. Në kuadër të këtyre takimeve SBASHK falënderoi koleget e kolegët që janë pensionuar e duke respektuar kontributin e tyre u ndanë mirënjohje dhe u premton se kontributi i tyre do të respektohet sot e gjithmonë. Duke kremtuar ditën e mësuesit dhe shkollës shqipe ndjemë obligim që, për hir të përpjekjeve të mëdha të njerëzve të pendës, të vazhdojmë me misionin e shenjtë të edukimit e arsimimit të brezave dhe me rrugëtimin bashkë e në SBASHK sepse unik e të bashkuar shumë më lehtë do të përballemi me sfidat e kohës.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Bashkëbisedim

Bisedë me kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj

Në fillimet e marsit është dita e mësuesit dhe shkollës shqipe. Për këtë numër të gazetës sonë biseduam me kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj.



E pyetëm se cila është pozita e mësuesit sot në shoqëri dhe ai ktheu fillimisht kujtesën në vitet e dekadat e shkuara dhe shprehu bindjen se dikur profesioni i mësuesit ishte shumë i nderuar, por tani nuk është kështu. “Është lënduar shumë figura e mësuesit kohëve të fundit. Dikur mësuesi gëzonte respekt meritë dhe fjalë e

këshilla e tij kishin peshë, tani vërehet një përprjekje, nga njerëz që nuk kanë as edhe një përvojë të vogël në arsim, që të lëndohet publikisht figura e mësuesit dhe kjo po ndikon që edhe disiplina në shkolla të bie vazhdimisht dhe kur nuk ka disiplinë vështirë është të shënohen arritje të duhura. Kështu si është gjendja tani në të ardhmen e afërt mund të kemi mungesë të kuadrit arsimor sepse ky profesion më nuk është tërheqës për të rinjtë sepse ka shumë sfida, pagat nuk janë ato që duhet e po ashtu edhe kushtet e punës në shkolla nuk janë të shekullit 21”, thotë Jasharaj.

Kryetari i SBASHK-ut foli edhe për angazhimet momentale të SBASHK-ut duke u ndalur të shënimi i ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe. Ai tregoi se SBASHK-u ka vazhduar

me traditën e mirë që nëpër komuna të organizohen takime me pishtarët e dijes dhe t’u ndahen mirënjohje në shenjë respekti për angazhimet në misionin e shenjtë për edukimin e arsimimin e brezave dhe për kontributin në aktivitetet sindikale.

Në kuadër të kësaj bisede për gazetën tonë kryetari Jasharaj veçoi edhe organizimin e trajnimeve nëpër komuna për personelin arsimor që janë anëtarë të SBASHK-ut. “Falë përkushtimit të stafit qendror dhe të kryetarëve të nivelit komunal sindikal në shumë komuna të Kosovës çdo vikend po organizohen trajnimet për programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe për “Forcimin e kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, deklaroi kryetari Jasharaj duke shprehur respekt edhe për trajnerët që janë shumë të përkushtuar për arritjen e objektivave të këtij aktiviteti. Ai thekson se me trajnimet do të vazhdohet edhe në të ardhmen duke respektuar vullnetin e anëtarësisë kudo në komunat e Kosovës.

Kryetari Jasharaj në fund të kësaj bisede thekson se falë angazhimit të sekretarit të përgjithshëm Ymer Ymeri dhe tërë stafit qendror që tani kanë nisur përgatitjet për organizimin e aktivitetit tradicional për dërgimin e një numri të konsideruar të anëtarëve e anëtarëve për pushime në bregdetin shqiptar.

Gjatë muajit

Plani i Punës së Komunikimit është pjesë e Planit Strategjik 2027-2030 të SBASHK-ut

SBASHK mbajti punëtori dyditore për hartimin e planit të komunikimit 2027-2030



Gjatë muajit mars, SBASHK mbajti një punëtori dyditore për hartimin e Planit të Punës për Komunikimin 2027-2030 e cila është pjesë e Planit Strategjik të SBASHK-ut për të njëjtën periudhë.



Tryezën e hapi kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili tha se SBASHK ka qenë në vazhdimësi i hapur me publikun përmes mediave ku edhe ka ndërtuar një bagazh në zhvillimin e komunikimit publik edhe me publikun. Jasharaj tha se ndjehet mirë që për rrjedhën e mbarë të konferencës do të kujdeset prof. Dr. Alban Zeneli, i cili i ka dhënë këshilla për qasjen ndaj mediave, e të cilat kanë dhënë rezultate ngase SBASHK ka qasje korrekte ndaj mediave.



Ndërsa fjalë rasti pati edhe kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli, i cili e përshëndeti këtë tryezë dhe i dëshiroi sukses të gjithë pjesëmarrësve.

Kurse zyrtarja e programit të Qendrës së Solidaritetit, e cila e mbështet SBASHK-un në këtë punëtori, Bruna Hylviu, tha se qëllimi i Qendrës së Solidaritetit është mbështetja e SBASHK-ut në ndërtimin e këtij plani.



Ajo e falënderoi profesorin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, Alban Zeneli, i cili e ka propozuar versionin kryesor të këtij plani si dhe e ka udhëheqë këtë tryezë.


Po ashtu, në diskutim kishin marrë pjesë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut të cilët ishin nga shumica e komunave të Kosovës.

Në tryezë ishin diskutuar tema si: Pozicionimi strategjik dhe narrativa e SBASHK-ut, prioritetet dhe audiencat, mjetet, strukturat dhe planifikimi vjetor i SBASHK-ut si dhe konkluzionet e konferencës.



Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, tha se duhet të bëhen ndryshime në sindikatë duke i identifikuar problemet, duke filluar përmes Shoqatave Sindikale deri tek niveli qendror i SBASHK-ut.

SBASHK apel mësimdhënësve të Arsimit Parauniversitar: Mos nënshkruani kontrata të reja të punës



Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, tha se SBASHK-un e dallon rezistenca në organizimin shpirtëror të mësimit në kohën e okupimit serb. “SBASHK ka qenë shtyllë e organizimit të mësimit shqip nëpër shtëpi si dhe gjatë egzodit në Maqedoni dhe Shqipëri me mësimdhënës të shpërngulur dhe nxënës shqiptar. Këto virtyte e dallojnë SBASHK-un prej sindikatave tjera dhe e vetmja organizatë që mbi 80 për qind të të punësuarve në sektor, i ka anëtar”, tha Ymeri.

Qamil Hajdini, kryetar i NSKAP-it për Prishtinë, tha se është i nevojshëm digjitalizimi i shërbimeve digjitale dhe shfrytëzimi i tij.



Kurse Makfirete Zuka nga Vitia, kërkoi depolitizimin e institucioneve arsimore dhe heqjen e mbingarkesës së mësimdhënësve në punë. Të njëjtin shqetësim e patën edhe përfaqësuesit e kokunave tjera si Suhareka, Prizreni etj.



Ndërsa, zyrtari Ligjor në SBASHK tha se nuk ka nevojë për një sqarues digjital për pyetjet e sindikalistëve pasi sipas tij të emëruarit nëpër pozita sindikale, përgjigjet që lidhen me Statutin e SBASHK-ut duhet t'i kenë të qarta dhe të njohura.

Gjatë muajit mars SBASHK kishte dalë me një reagim pasi përsëri në disa komuna, e veçanërisht në komunën e Vushtrrisë ishte aktivizuar kërkesa për nënshkrimin e kontratave të reja të punës përkundër që mësimdhënësit e Arsimit Parauniversitar i kanë kontratat e punës me afat të pacaktuar.

“Versionet që po qarkullojnë e që i posedon SBASHK-u janë më të pafavorshme se kontratat ekzistuese dhe nuk janë në përputhshmëri me UA10/2015 për kontratat e punës për mësimdhënësit e Arsimit Parauniversitar.

Njoftojmë anëtarësinë por edhe punëdhënësit, se kontratat e ofruara në këtë formë siç po i ofroni janë jo-ligjore, për shkak se nuk janë në përputhje me Udhëzimin Administrativ të lartëcekur dhe ju bëjmë me dije se SBASHK është në kontakt me Sindikatat e Arsimit të Regjionit dhe Europës dhe është duke analizuar kontratat e punës së tyre ku ka vërejtur se në kontratë të punës nuk duhet të ketë shumë të parave, por vetëm koeficient e benefite tjera në formë koeficienti, dhe shumë shpejtë do të dalë me një version të pranueshëm

për anëtarësinë tonë, dhe do të ia ofrojë Asociacionit të komunave të Kosovës.

Prandaj kërkojmë nga komunat që të ndalin presionin ndaj mësimdhënësve për nënshkrimin e këtyre farë versioneve të kontratave të punës që po qarkullojnë. Po ashtu, apelojmë te anëtarësia që kanë kontrata në kohë të pacaktuar të mos i nënshkruajnë këto farë versione të kontratave të punës edhe përkundër presioneve që mund t'i kenë nga punëdhënësit", thuhej në reagimin e SBASHK-ut.

7 Marsi-Dita e Mësuesit

Pishtarë të dijes urime dita e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe



Të nderuar pishtarë të dijes, kolege e kolegë gëzuar dhe urime 7 Marsi, kjo ditë e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe. Është kjo datë që shënon nismën e përpjekjeve sublime të njerëzve të dijes në mbrojtje të dritës nga errësira.

Në këtë ditë lartësojmë kujtimin për mësuesit e parë të

kombit dhe shprehim respektin meritore për punëtorët e arsimit shqip nëpër vite, dekada e shekuj ishin në shërbim të edukimit e arsimit të brezave. Shprehim respektin e lartë dhe i përkulemi kujtimin për mësuesin e dëshmorin Shaban Jashari dhe për kolegët tanë që në vitet 90-ta mbrojtën arsimin dhe shkollën shqipe nga furtunat e pushtuesit.

Bashkë e në SBASHK do të vazhdojmë rrugëtimin me përpjekjet e vazhdueshme për realizimin e kërkesave tuaja dhe në shërbim të një arsimit edhe më cilësor. Urojmë që kjo datë e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe dhe kontributi i madh i pishtarëve të dijes nëpër vite e dekada në shërbim të kombit e atdheut të jetë shtytje shtesë për institucionet që të bëjnë angazhim konkretet në shërbim të arsimit dhe për realizimin e kërkesave tuaja legjitime.

SBASHK ka vazhduar aktivitetet për nder të Ditës së Mësuesit

Aktivitete festive të SBASHK-ut për nder të ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe

SBASHK-u edhe këtë vit kudo në komunat e Kosovës dhe në universitete kishte organizuar aktivitete festive për ditën e mësuesit dhe shkollës shqipe. Në kuadër të këtij aktiviteti ishin organizuar edhe takime solemne në shenjë respekti për anëtarët e anëtarët e pensionuar nga marsi i vitit të kaluar e deri në periudhën e njëjtë të këtij viti.



Të 430 anëtareve e anëtarëve të pensionuar gjatë kësaj etape kohore iu ndanë mirënjohje në shenjë respekti për

gjithë angazhimet për edukimin e brezave nëpër vite e dekada. Në këto takime solemne pjesëmarrësit ishin të emocionuar dhe falënderonin SBASHK-un që nuk ka harruar kontributin e tyre në misionin e shenjtë të edukimit e arsimit të brezave.



Ata në bisedë të lirshme me njëri-tjetrin spontanisht shpalosnin kujtime për angazhimet në vitet dhe dekadat

e kaluara. Të gjithë u shprehen krenar që kanë punuar me zell e përkushtim në vitet e 90-ta duke bërë angazhime të vazhdueshme në mbrojtje të arsimit shqip nga furtunat e pushtesit.



Në këto takime solemne SBASHK kishte shprehur mirënjohjen e thellë ndaj të gjithë punonjësve arsimorë të cilët me angazhimin e tyre kanë bërë që të mos shuhet arsimi dhe gjuha shqipe ndër breza.



SBASHK vazhdoi me zgjedhje sindikale edhe gjatë muajit mars Zgjedhjet Sindikale në Deçan – Kryetar u rizgjodh Burim Avdiaj, ndërsa nënkryetare Sanije Thaqi



Në Deçan gjatë muajit mars u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku u zgjodhën kryetari, nënkryetarja, kryesia e re e NSKAP-it të Deçanit, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.


Gjatë procesit zgjedhor në Deçan ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj dhe Kryetari i komisionit statutar, Blendor Shatri. Procesi zgjedhor në Deçan u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kryetar i NSKAP-it të Deçanit u rizgjodh Burim Avdiaj, ndërsa nënkryetare, Sanije Thaqi.



Kuvendi i NSKAP-it të Deçanit i propozoi Kongresit të SBASHK-ut kandidaturën e z. Blendor Shatri për Kryetar të SBASHK-ut, ndërsa propozoi që z. Ymer Ymeri t'i vazhdohet edhe një mandat si Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.

Ky kuvend u organizua në kuadër të zgjedhjeve të rregullta, të cilat ishin shpallur në vitin 2025 dhe ishin mbajtur në të gjitha shoqatat sindikale, për të vazhduar edhe në të gjitha nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut.

Në kuadër të aktiviteteve sindikale gjatë marsit Në Prizren u mbajt Kuvendi i punës



Të enjten e 13 marsit në Prizren u mbajt një kuvend i punës, ku u propozuan edhe kandidatët për kryetar të Nivelit Sindikal Komunal të Prizrenit.



Në këtë Kuvend pune, kandidatë për kryetar të NSKAP-it për Prizren u propozuan Hyrije Hoti, Shqipe Tabaku dhe Driton Gashi.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Të pranishmit me një fjalë rasti i përshëndeti kryetari aktual i NSKAP-it për Prizren, Reshit Kushaj, i cili u dëshiroi edhe kuvend të mbarë të punës.

Në këtë kuvend pune në Prizren, të pranishëm ishin

SBASHK u përfaqësua në mbledhjen e Komitetit të Përhershëm të Sindikatave të Arsimit (ETUCE) të mbajtur në Rumani



Në Bukuresht të Rumanisë, gjatë datave 16–17 mars 2026, ishte mbajtur takimi i Komitetit të Përhershëm për Barazi i Komitetit Evropian të Sindikatave të Arsimit (ETUCE), i cili ishte zhvilluar në selinë e Federatës së Sindikatave të Lira të Arsimit të Rumanisë (FSLI).



Në këtë takim pjesëmarrës ishte delegacioni i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBASHK), i përfaqësuar nga anëtari i këtij komiteti dhe Sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri, i shoqëruar nga nënkryetarja Vjollca Shala dhe zyrtarja për marrëdhënie me jashtë, Shukrie Gori.

Takimi ishte hapur nga Presidenti i ETUCE, John MacGabhann, i cili në fjalën e tij theksoi rëndësinë e mbrojtjes së vlerave themelore evropiane – barazisë, përfshirjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut

edhe udhëheqës të lartë të SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala, sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi.

në arsim dhe në shoqëri. Ai nënvizoi se sindikatat e arsimit kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e solidaritetit, në mbrojtjen e dinjitetit të çdo njeriu dhe në kundërshtimin e çdo forme diskriminimi, pavarësisht përkatësisë etnike, besimit, gjinisë apo orientimit.



Në kuadër të agjendës së ditës së parë ishte diskutuar për punën e bërë gjatë vitit 2025 në fushën e barazisë dhe përfshirjes në arsim, si dhe për rekomandimet për sindikatat lidhur me përfshirjen e migrantëve dhe refugjatëve në arsim dhe në profesionin e mësimdhënies. Po ashtu, pjesëmarrësit punuan në grupe për të shqyrtuar udhëzimet e projektit për përfshirjen e personave me nevoja të veçanta dhe aftësi të kufizuara në sistemin arsimor.





Diskutimet kishin vazhduar edhe gjatë ditës së dytë të takimit, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet sindikatave të arsimit në Evropë dhe avancimin e politikave të barazisë dhe përfshirjes në arsim.





Trajnimet

Gjatë muajit mars SBASHK organizoi disa grupe të trajnimit për mësimdhënës
**Në Klinë, Viti, Gjilan e Kamenicë u mbajtën testet pas përfundimit të trajnimeve
kurse në Obiliq e Skenderaj filluan grupe të reja**



SBASHK gjatë muajit mars kishte organizuar një varg trajnimesh për mësimdhënësit anëtar, derisa i kishte përmbyllur disa të tjera duke e mbajtur testin përfundimtar.



Në javën e fundit të marsit SBASHK kishte organizuar testin për një grup të mësimdhënësve në Klinë të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”. Testi ishte administruar nga zyrtari Ligjor në SBASHK, Blendor Shatri, derisa trajnimi ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Burim Krasniqi.



Kurse në Viti testi ishte organizuar një ditë më parë, për një grup të mësimdhënësve të cilët e kishin përfunduar trajnimin në po të njëjtin program, nën udhëheqjen e trajnerit Musli Neziri.



Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi. Ndërkohë për tu kujdesur për mbarrëvajtjen e testimit, e pranishme ishte edhe kryetarja e zgjedhur e NSKAP-it për Viti, Makfirete Zuka.



Ndërsa, në po të njëjtën fundjavë, SBASHK kishte filluar me dy grupe të trajnimit në Obiliq, një në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe tjetri në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”.




Në programin e parë, trajner i përzgjedhur nga SBASHK ishte Xhelal Krasniqi, kurse në të dytin trajner i përcaktuar nga SBASHK ishte Emrush Ahmeti. Mësimdhënësit të cilët e kishin filluar trajnimin i kishte vizituar edhe kryetarja e NSKAP-it për Obiliq, Luljeta Boshnjaku, e cila u kishte dëshiruar suksese dhe arritje sa më të larta profesionale.

Kurse, në Skenderaj SBASHK kishte filluar me dy grupe të trajnimit disa javë më parë në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

Trajneret Arbenita Gashi dhe Fatlume Mehmeti ishin përcaktuar nga SBASHK për udhëheqjen e këtyre grupeve derisa trajnimet ishin mbajtur në shkollën “Shaban Jashari”.

Kurse për t'u kujdesur për mbarrëvajtjen e trajnimit, mësimdhënësit i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Skenderaj, Shpend Rexha, i cili pjesëmarrësve u kishte dëshiruar sukses dhe arritje të larta profesionale.



Ndërkohë, gjatë kësaj të shtune, SBASHK kishte


Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

organizuar edhe testet për tri grupe tjera të mësimeve të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime", dy në Kamenicë dhe një në Gjilan.



Testet ishin administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi. Kurse të pranishëm ishin edhe kryetarët e Niveleve Sindikale Komunale të Kamenicës dhe Gjilanit, Lulzim Thaqi, respektivisht Blerim Mehmeti.

Trajnimet në Kamenicë ishin udhëhequr nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Xhemal Kastrati kurse në Gjilan nga trajnerja Ibadete Limoni.



SBASHK vazhdon me mbështetjen e mësimeve anëtar përmes trajnimeve të licencuara të cilat i ofron për anëtarësinë e vet pa pagesë.

SBASHK priti drejtorin e Institutit "Musine Kokalari", u diskutua për zhvillimin dhe modernizimin e sindikatës



Me qëllim të avancimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, SBASHK ka pritur në takim drejtorin e Institutit për Politika Sociale "Musine Kokalari", Visar Ymeri, së bashku me bashkëpunëtorët Donika Marku Gashi dhe Drenusha Canolli.

Në këtë takim morën pjesë nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe sekretari i përgjithshëm, Ymer Ymeri, të cilët prezantuan gjendjen aktuale të sindikatës, sfidat dhe prioritetet për zhvillimin e saj në të ardhmen.

Gjatë diskutimit, u theksua se SBASHK aktualisht përfaqëson mbi 80% të punonjësve të arsimit në Kosovë, duke qenë një ndër organizatat më përfaqësuese në vend, me rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të mësimeve dhe punëtorëve të arsimit.

Sekretari i përgjithshëm, Ymer Ymeri, në fjalën e tij theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi, duke u shprehur: "I nderuar Visar, drejtor i Institutit për Politika Sociale 'Musine Kokalari',

Ju falënderojmë për gatishmërinë për këtë takim dhe për interesimin tuaj për bashkëpunim me SBASHK.



Si një organizatë që përfaqëson një numër të madh të punëtorëve të arsimit në të gjitha nivelet, SBASHK-u sot përballlet me sfida të shumta, por njëkohësisht ka edhe nevojë të qarta për zhvillim të mëtejshëm. Në këtë drejtim, ne vlerësojmë se bashkëpunimi ynë mund të fokusohet në disa fusha kyçe: Së pari, kemi nevojë për fuqizim të kapaciteteve sindikale, veçanërisht në aspektin e



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

negocimit kolektiv, dialogut social dhe komunikimit strategjik me institucionet.

Së dyti, e shohim shumë të rëndësishme mbështetjen në hulumtime dhe analiza, të cilat do të na ndihmonin të kemi argumente më të forta në përfaqësimin e interesave të anëtarëve tanë, sidomos lidhur me kushtet e punës, pagat dhe mirëqenien e mësimdhënësve.

Së treti, kemi nevojë për avancim në avokim dhe ndikim në politika publike, në mënyrë që zëri i mësimdhënësve të jetë më i pranishëm në proceset vendimmarrëse.

Po ashtu, një fushë e rëndësishme është digjitalizimi dhe modernizimi i sindikatës, për të përmirësuar komunikimin me anëtarësinë dhe për të rritur efikasitetin organizativ.

Ne gjithashtu synojmë të punojmë më shumë në aktivizimin e të rinjve, në barazinë gjinore, si dhe në ngritjen e transparencës dhe qeverisjes së brendshme.

Besojmë se përmes trajnimeve të përbashkëta, të dizajnuara sipas nevojave reale të SBASHK-ut, mund të arrijmë rezultate konkrete dhe të qëndrueshme.

Në fund, dua të theksoj se jemi të hapur për bashkëpunim afatgjatë dhe për ndërtimin e një partneriteti që kontribuon jo vetëm në forcimin e sindikatës sonë, por edhe në përmirësimin e përgjithshëm të sistemit arsimor

në vend.”

Kurse, drejtori i Institutit, Visar Ymeri e falënderoi SBASHK-un për pritjen dhe bashkëpunimin duke thënë se pikat kyqe të nevojës së SBASHK-ut të cilat iu dorëzuan, do t'i shqyrtojë dhe të shërbejnë për bashkëpunimin dy vjeqare që do ta kem.

Në takim u diskutua edhe për sfidat aktuale me të cilat përballen punonjësit e arsimit, përfshirë çështjen e kontratave të reja të punës në disa komuna, për të cilat SBASHK ka shprehur shqetësimin e saj, duke i konsideruar ato të pafavorshme për mësimdhënësit dhe në kundërshtim me të drejtat e tyre ligjore.

Gjatë takimit, përfaqësuesit e SBASHK-ut prezantuan nevojat konkrete të sindikatës, mbi të cilat synohet ndërtimi i një bashkëpunimi të strukturuar me Institutin “Musine Kokalari” në një periudhë dyvjeçare, me fokus në ngritjen e kapaciteteve profesionale, mbështetjen në hulumtime dhe organizimin e trajnimeve të specializuara.

Takimi u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një partneriteti të qëndrueshëm, në funksion të zhvillimit të sindikatës dhe përmirësimit të kushteve për punonjësit e arsimit në Kosovë.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture